

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 772 Prot.

Tiranë, më 19.072016

VENDIM Nr. 82, datë 15.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9 të datës 15.07.2016, pasi shqyrtoi *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike* në Stacionet e Bllokimit të Valvulave (BVS 27 Potom, BVS 24 Progër, BVS 30 Ura Vajgurore) dhe Sheshet e Magazinimit të Tubave (APY 03 Qafë, APY 01 Eçmenik, APY 06 Vodice), në kuadër të *Projektit TAP*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike* në Stacionet e Bllokimit të Valvulave (BVS 27 Potom, BVS 24 Progër, BVS 30 Ura Vajgurore) dhe Sheshet e Magazinimit të Tubave (APY 03 Qafë, APY 01 Eçmenik, APY 06 Vodice), në kuadër të *Projektit TAP*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Investitori TAP AG për kryerjen e sondazheve arkeologjike sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga shoqëria e licencuar në arkeologji, duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me këtë shoqëri dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO